



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
POSTA SHQIPTARE SH.A
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
DREJTORIA LIGJORE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(PAS PROCESIT TË ANKIMIT)

Datë 21.06.2023

Drejtuar: Operatorin Ekonomik “Abissnet” SH.A., me NUIS K01417001C.

Me adresë: Njësia Bashkiake nr.5, Rruga “Ismail Qemali”, Pallati nr. 18, Kati II, Tiranë.

Procedura e prokurimit: “Të hapur mbi kufirin e lartë monetar”

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-54512-12-21-2022

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 2 vite”, me fond limit **60,000,000 (gjashtëdhjetë milion)** lekë pa TVSH.

Në euro - 524,705 (pesëqind e njezet e katër mijë e shtatëqind e pesë) euro, pa TVSH.

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike datë 27.12.2022, nr. 176
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar ne kosto
- oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj, ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori “Abissnet” SH.A. NUIS K01417001C me ofertë ekonomike **39,231,360** (tridhjetë e nëntë milion e dyqind e tridhjetë e një mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë **pa TVSH.**
2. B.O. “Albanian Telecommunications Union” SH.P.K. NUIS L014250001U & “Digicom” SH.P.K. NUIS L42018012R me ofertë ekonomike **45,817,640** (dyzet e pesë milion e tetëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë **pa TVSH.**
3. B.O. “Communication Progress” SH.P.K. NUIS K01625001C & “One Albania” SH.A. NUIS J61814094W me ofertë ekonomike **49,995,360** (dyzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë **pa TVSH.**

4. Operatori “Vodafone Albania” SH.A. NUIS **K11715005L** me ofertë ekonomike **53,009,988** (pesëdhjetë e tre milione e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. B.O. “Albanian Telecommunications Union” SH.P.K. NUIS L014250001U & “Digicom” SH.P.K. NUIS L42018012R për arsye se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga **B.O. “Albanian Telecommunications Union” SH.P.K. NUIS L014250001U & “Digicom” SH.P.K. NUIS L42018012R** u konstatua se:

Bashkimi i operatoreve ekonomik në kundërshtim me pikën 2 të nenit 88 të VKM 285, datë 19.05.2021, ka paraqitur sigurimin e ofertës duke mos specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në Nenin 88 - Bashkimi i operatorëve ekonomikë, pika 2 sipas VKM 285, datë 19.05.2021, parashikohet se: ***Përfaqësuesi duhet të bëjë sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomik.***

Në lidhje me plotësimin e pikës **2.3.4 Kapaciteti teknik** nga ana e Autoritetit Kontraktor është kërkuar:

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e plotë të zgjidhjes teknike për ofrimin e shërbimeve të kërkuara të linjës primare dhe back-up, të shoqëruar me përshkrimin dhe skemat e rrjetit të ofruesit të shërbimit për çdo pikë. Nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor, kjo duhet të jetë e provueshme në 10 (dhjetë) zyra postare të përzgjedhura nga AK, brenda 7 (shtatë) ditësh kalendarike.

1. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur një dokumentacion të plotë të zgjidhjes teknike për ofrimin e shërbimeve të kërkuara, pasi mungojnë përshkrimi dhe skemat e rrjetit të ofruesit të shërbimit për çdo pikë.

2. BOE ATU dhe Digicom ka paraqitur kontrata bashkëpunimi për përdorim të rrjetit të komunikimeve elektronike me operatorët Diginet e Tele.Co, por në dokumentin e zgjidhjes teknike të operatorit nuk është paraqitur asnjë informacion teknik për lidhjen/integrimin e rrjetit dhe shërbimit të JV ATU/Digicom me rrjetat e këtyre operatoreve.

8. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur marken e paisjeve fundore që do të përdorë, të cilat duhet të jenë “Brand-Name”.

9. Operatori ekonomik nuk ka demonstruar redundancë në nivelin e transmetimit në rrjetin e tij.

10. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur përshkrim të mjeteve për virtualizimin e aplikacioneve qendrore të aksesuara nga njesitë e largëta.

11. Për realizimin e lidhjes Backup, OE nuk jep asnjë përshkrim, detaj teknik apo skemë lidhje të realizimit të saj, përveçse formës tabelare ku në kolonën e dytë “Mënyra e lidhjes Backup” shprehet termi “Fiber” dhe “Antenë”. Terma të cilat nuk ofrojnë dhe garantojnë asgjë rreth mënyrës së ofrimit të lidhjes backup, për më tepër termi “Antenë” i referohet një pajisje fundore të përgjithshme në transmetimet valore por jo teknologjisë konkrete që OE do të perdore për kryer Lidhjen Backup.

2.3.5 *Operatori ekonomik duhet të zotërojë një infrastrukturë të vetën për shtrirjen e rrjetit me mbulim në të gjitha qytetet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, që vërteton kapacitetin e Operatorit Ekonomik për realizimin e shërbimit, ose në rast se operatori nuk disponon një infrastrukturë të vetën shtrirje rrjeti, të kërkuara në këto specifikime, atëherë operatori duhet të paraqesë në procedure prokurimi një kontratë qiraje/marrëveshje bashkëpunimi me një operator të licensuar nga AKEP (Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare).*

Kjo kontratë e qirasë/marrëveshje bashkëpunimi, në rastin e marrjes së këtij shërbimi, duhet të dokumentohet për ofrimin e shërbimit me mbulim në të gjithë qytetet.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim/Certifikatë/Autorizim nga AKEP-i, se operatori ka shtrirje rrjeti kombetare në mbare Shqipëri sipas vendodhjeve të pikave postare të autoritetit kontraktor.

- në rastin e kontratës me qira/marrëveshje bashkëpunimi, operatori ekonomik paraqet Vërtetim/Certifikatë/Autorizim nga AKEP-i, në emër të operatorit qiradhënës/bashkëpunues, e cila mbulon afatin e kontratës për ofrimin e aksesit të internetit sipas pikave ku ka vendndodhjen autoriteti kontraktor.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur një dokumentacion që zotëron një infrastrukturë të vetën për shtrirjen e rrjetit me mbulim në të gjitha qytetet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Dokumenti “Certifikate e Konfirmimit të Njoftimit” Nr.2012-AP-U251-8-2/ datë 09.05.2012 dhe “Certifikate e Konfirmimit të Njoftimit” Nr.2012-AP-00504/ datë 30.01.2019 lëshuar nga AKEP është një dokument që AKEP lëshon për konfirmimin e kryerjes së regjistrimit të Njoftimit, sipas pikës 5 të nenit 3 të ligjit nr. 9918, por nuk provon që operatori ekonomik zotëron një infrastrukturë të veten. Në dokument deklarohet vetëm se zona e njoftuar nga OE është në 61 bashkitë e vendit.

- Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të secilit operatorë si dhe në Kontratën e bashkëpunimit në emertesen e zërave ku merret përsipër ofrimi i shërbimit ***nuk përfshihen të gjitha filialet postare*** por specifikohet konkretisht:

- ***ATU do të realizojë zërat e shërbimit: - Do të lidhë Replikimi data center (site 1 Posta Qendrore Site 2 Posta Tiranë) me FO të dedikuar, Lidhja me ISSH me FO të dedikuar, me shërbim Intranet pjesërisht Tiranën dhe Durrësin, me shërbim Intranet Shijakun dhe Vlore.***

- ***Digicom do të realizojë zërat e shërbimit- Do të lidhë me shërbim internet Filiali Dega Tiranë, Shërbim Intranet Filiali Dega Tranzit, pjesërisht Tiranën dhe pjesërisht Durrësin.***

2. Operatori “Vodafone Albania” SH.A. NUIS K11715005L, për arsye se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori “Vodafone Albania” SH.A. NUIS K11715005L u konstatua se:

▪ **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në këtë procedurë prokurimi konstatohet se Operatori “Vodafone Albania” SH.A. NUIS K11715005L ka paraqitur ofertë në vete por njëkohësisht ka dhënë mbështetje edhe për operatorin “Abissnet” SH.A. NUIS K01417001C duke lidhur marrëveshjen nr. Ref: EM 001/A202 datë 19.01.2023 për:**

Përshkrimi i produktit:

1- Produkti privat APN është krijuar për tu përshtatur nevojave të komunikimit në Internet të Pajisjeve IOT me njesinë më të ulët të tarifimit prej 1KB, e cila është pothuajse e barabartë me madhësinë e çdo transaksioni të komunikuar nga pajisjet IOT.

2- Plani tarifor për këtë shërbim ofron një plan pako të dhënash prej MB në muaj, i cili falë njësisë së tarifimit shumë të ulët, mund të lejojë tranmetimin e të dhenave me frekuencë të lartë nga pajisjet IOT pa tejkalar paketën mujore. Gjithashtu, ky shërbim, përveçtransmetimit të të dhenave në internet, ofron edhe mundësinë e dërgimit dhe marrjes së SMS-ve.

Në nenin 88, “Ndërhyrja në ofertë” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, *parashikohet:*

1. Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.

2. Ndërhyrje në ofertë do të konsiderohet edhe pjesëmarrja e dy ose më shumë ofertuesve me të njëjtin ortak dhe/ose administrator në të njëjtën procedure prokurimi.

3. Autoriteti/enti kontraktor vlerëson rast pas rasti nëse konstaton të dhëna të tilla, që mund të shërbejnë si tregues për ndërhyrje në oferta nga ana e operatorëve ekonomikë ofertues.

Në nenin 76, Kriteret detyruese për skualifikim, pika 3, germa ç) të ligjit nr.162, datë 20.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, *parashikohet:*

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

Në analizë të dokumentacionit të dorëzuar në ofertë nga operatori “Abissnet” SH.A. NUIS K01417001C dhe dokumentacionit të dorëzuar në ofertë nga operatori “Vodafone Albania” SH.A. NUIS **K11715005L konstatohet se “Vodafone Albania” SH.A.** ka dorëzuar dokumentacion si pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi por njekohësisht ka lidhur edhe aktmarrëveshje me operatorin “Abissnet” SH.A. NUIS K01417001C për ta suportuar teknikisht në përmbushje të kriterëve tekniko ligjore për kualifikim për këtë procedurë prokurimi.

Në analizë të sa mësipër bazuar në nenin 88, “Ndërhyrja në ofertë” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe nenin 76, Kriteret detyruese për skualifikim, pika 3, germa ç) të ligjit nr.162, datë 20.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, **është vlerësuar si ofertë të pa rregullt.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se Operatori Ekonomik “Abissnet” SH.A., me NUIS K01417001C. **me adresë:** Njësia Bashkiake nr.5, Rruga “Ismail Qemali”, Pallati nr. 18, Kati II, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të totale prej **39,231,360** (tridhjetë e nëntë milion e dyqind e tridhjetë e një mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë **pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoriteti Kontraktor “Posta Shqiptare” sh.a., Adr.: Rr. “Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë**, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **49,995,360** (dyzet e nëntë milion e nëntëqin e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë **pa TVSH**, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesat: Ka patur ankesë nga operatori ekonomik **“Abissnet” SH.A.**, me NUIS K01417001C.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik me Vendimin Nr. 436/2023, datë 30.05.2023, ka vendosur:

1. *Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Abissnet” sh.a., për procedurën e mësipërme.*
2. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Abissnet” sh.a., dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.*
3. *Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit Brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera*

Autoriteti Kontraktor “Posta Shqiptare” sh.a., në përmbushje të Vendimit Nr.436/2023, datë 30.05.2023, ka bërë rivlerësimin e ofertave në SPE dhe në zbatim të pikës 3, të vendimit të sipërcituar, ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, se ka korrigjuar shkeljet e konstatuara nga KPP-ja.

Komisioni i Prokurimit Publik me **Vendimin Nr. 480/2023 datë 07.06.2023** ka vendosur, të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin e mëtejshëm të procedurës së prokurimit **“Të hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me REF- REF-54512-12-21-2022, me objekt: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 2 vite”, me fond limit 60,000,000 (gjashtëdhjetë milion) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.01.2023** nga autoriteti kontraktor “Posta Shqiptare” sh.a.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Ardit Demiri